



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.
____.____.2023

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 459, datë 25.07.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES TË
KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR ZNJ. {...}
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-07.02.2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:
 - A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

PASQYRIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSIA PROFESIONALE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës të komanduar znj. {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të dokumentave të hartuar, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës të gjyqtarës bazuar në raportin përshkruës vjetor të punës së gjyqtarës të komanduar, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e gjyqtarës të komanduar dhe në vetëvlerësimin e gjyqtarës. Aftësia profesionale e gjyqtarës të komanduar pikëzohet, sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkruës vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Referuar **“Raportit përshkruës vjetor të punës”**, rezulton se gjyqtarja e komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunëses përgjegjëse pranë Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etiko dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve ka hartuar 14 (katërbëdhjetë) projektraporthe standarde të analizimit të aftësive profesionale për 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë nga të cilët 10 (dhjetë) projektraporthe u përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apelit dhe 3 (tre) projektraporthe u përkasin gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë. Përgatitja e këtyre projektraportheve është kryer në zbatim të akteve ligjore në fuqi, konkretisht ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional” të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 24, datë 07.02.2019.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, analizohet se: *“Magjistratja e komanduar ka shfaqur aftësi të dukshme hulumtimi në drejtim të shqyrtimit dhe përpunimit në mënyrë tërësore burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore. Pjesë thelbësore e procesit të përgatitjes së projektraporteve është shortimi i 5 dosjeve të subjektit të rivlerësimit sipas kriterëve të parashikuara saktësisht në Aneksin bashkëlidhur Rregullores së miratuar me vendimin nr. 24 datë 07.02.2019 të KLGJ-së. Magjistratja e komanduar ka shfaqur aftësi të dukshme në administrimin e statistikave të sakta nga ana e gjykatës të cilat kanë shërbyer në vijim për përzgjedhjen e saktë të 5 dosjeve objekt analize, proces i cili kryhet nën mbikëqyrjen rigorozë të nëpunësit përgjegjës. Në procesin e shortimit të dosjeve të rivlerësimit i cili ishte shumë impenjativ, magjistratja e komanduar {...} ka shfaqur saktësi të lartë në mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, shpejtësi dhe kreativitet në zgjidhjen e situatave të paraqitura, duke shfrytëzuar burimet fizike dhe ato elektronike në funksion të qëllimit kryesor asaj të përzgjedhjes së dosjeve sipas rregullave të parashikuara nga Këshilli. Referuar përmbajtjes së 13 projektraporteve të hartuara nga magjistratja e komanduar {...}, evidentohet aftësia e saj për të paraqitur dhe analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar “burimet” për rivlerësimin e e aftësisë profesionale të parashikuara në nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr., 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, si dhe “burimet” e parashikuara në nenin 12 të Rregullores. Raportet janë hartuar nga ana e saj bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: i) Formularit të vetëdeklarimit të paraqitur si dhe 3 dokumentat ligjorë të paraqitur nga vetë subjektet e rivlerësimit si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti, ii) 5 dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; iii) Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së. Magjistratja e komanduar {...} në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale ka identifikuar dhe zbatuar me saktësi dispozitat e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në funksion të analizës së gjetjeve referuar kriterëve të vlerësimit: a) Aftësitë profesionale; b) Aftësitë organizative; c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në drejtim të evidentimit dhe analizës tërësore të burimit të të dhënave, rezulton se ato analizohen në mënyrë shumë të qartë, të saktë duke referuar në dokumentat dhe të dhënat e përfuara si nga formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentave të paraqitura nga vetë subjekti ashtu dhe të të dhënave të përfuara nga dosjet e shortuara. Lidhur me përcaktimin e elementëve faktikë të çështjes për trajtim, në të 13 projektraportet e hartuara nga ana e saj, magjistratja e komanduar referon në çdo rast në dokumentat dhe të dhënat e marra në kuadër procesit të rivlerësimit si dhe duke vënë në dukje faktin që paraqet rëndësi si nga përmbajtja ashtu dhe periudha kohore korresponduese me periudhën e rivlerësimit. Spikat aftësia e magjistrates për t’i përmbledhur dhe evidentuar elementët thelbësore që lidhen me analizën e gjetjeve. Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes për trajtim, në të gjitha projektraportet e hartuara prej saj si ato standarde ashtu dhe raportin shtesë të hartuar sipas kërkesës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, evidentohet aftësia e saj e dukshme në përcaktimin e qartë dhe në mënyrë të shprehur të gjetjeve konkrete dhe thelbësore të cilat analizohen si veçmas ashtu dhe në tërësi në funksion të kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes, gjetjeve konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit, aktet e shortuara apo burimet arkivore, lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në drejtim të analizës së gjetjeve. Kështu, në 13*

projektraportet standarde të hartuara nga magjistratja e komanduar {...}, në analizimin e gjetjeve nga burimet e vlerësimit të subjektit, ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 42;
- Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Neni 6 mbi respektimin e standardit të procesit të rregullt ligjor;
- Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kriteret e vlerësimit profesional dhe etik të magjistratit të përcaktuar në këtë ligj;
- Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimin e KLD-së nr. 261/2 datë 14.04.2010 “ Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve “ dhe Ankesin Nr. 1 “ Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”;
- Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “ Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (shih raportin për subjektin Sh.H).
- Vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të cilat janë të detyrueshme për zbatim në të njëjtën çështje (shih raportin për subjektin B.SH).
- Identifikon praktikë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë në gjetjet dhe analizën e gjetjeve në projektraportet e subjekteve të rivlerësimit të cilat aplikohen në drejtim të standardeve objekt vlerësimi.
- Dispozita materiale dhe procedurale të legjislationit penal, civil, civil familjar dhe administrativ, mbi vlerësimin e afateve të gjykimit, të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, apo dhe të efektivitetit në gjykim të subjektit të rivlerësimit.

Në raportin shtesë të hartuar me kërkesë të KPK-së ndaj një gjyqtari, magjistratja {...} ka identifikuar dhe referuar ligj të zbatueshëm:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Nenin Ç i Aneksit, mbi dhënin e informacionit shtesë për organet e vetëqeveritjes;
- Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi përkimin e kohës së dhënies së dokumentit me periudhën rivlerësimit duke referuar nenin 41 të ligjit nr. 84/2016;
- Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim apo verifikim të ankesave sipas nenit 120 të këtij ligji.

Në drejtim të analizës së konfliktit të normave, magjistratja e komanduar ka shfaqur aftësi të dukshme hulumtimi për të identifikuar natyrën e çështjes në trajtim edhe vlerësimin e subjektit në përputhje me ligjin specifik të zbatueshëm si dhe konfliktin e normave procedurale në rastet e trajtimit të çështjeve penale të posaçme siç është ligji nr. 10192/2009 “Antimafia” nga subjektet e rivlerësimit. Gjithashtu, megjithëse nuk ka qenë e nevojshme një analizë në drejtim të konfliktit të normave, në një rast ka rezultuar të jetë trajtuar aplikimi i kriterëve matëse sipas Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve të përcaktuar në vendimin e KLD-së nr. 261/2 datë 14.04.2010 në raport me ligjin specifik nr. 49/2012, i hyrë në fuqi pas vendimit të KLD-së, mbi afatin standard minimal të gjykimit të çështjeve administrative (shih raportin për subjektin B.Sh.). Magjistratja e komanduar {...} ka shfaqur nivel të lartë të njohurive mbi legjislationin dhe jurisprudencën. I kushton rëndësi përditësimin të këtyre njohurive, për të njohur dhe

aplikuar pjesët e reja të legjislacionit si dhe vendimeve unifikuese. Ajo ka aftësi të dukshme në hartimin e qartë të projektraporteve, në identifikimin e saktë të rrethanave të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Në çdo rast, në analizën e gjetjeve mbi vlerësimin e aftësive në interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga subjektet e rivlerësimit, nga ana e magistrates është mbajtur në konsideratë neni 72 pika 4 të Ligjit Nr. 96/2016 “ Për Statusin”, në të cilin parashikohet “ Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”, duke u garantuar pavarësia e magistratit në zgjidhjen e çështjes”.

Në përfundim, lidhur me këtë tregues Struktura Përgjegjëse Organizative konkludon se: “Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko-Profesional të ngritur pranë Komisionit të vlerësimit për efekt vetingu, ka treguar aftësi të larta për të evidentuar qartë, shpejt dhe saktë të dhënat, identifikon shumë qartë natyrën e çështjes, gjetjet konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit. Evidentimi i të dhënave kryhet prej saj saktësisht duke referuar në dokumentat dhe të dhënat e përftuara si nga formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentave të paraqitura nga vetë subjekti ashtu dhe të të dhënave të përftuara nga dosjet e shortuara. Spikat aftësia e magistrates për t’i përmbledhur dhe evidentuar elementët thelbësore që lidhen me analizën e gjetjeve. Evidentohet aftësia e saj e dukshme në përcaktimin e qartë dhe në mënyrë të shprehur të gjetjeve konkrete dhe thelbësore të cilat analizohen si veçmas ashtu dhe në tërësi në funksion të kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes, gjetjeve konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit, aktet e shortuara apo burimet arkivore, lidhet me identifikimin e saktësisht prej saj të ligjit të zbatueshëm në drejtim të analizës së gjetjeve. Magistratja e komanduar {...} ka shfaqur nivel të lartë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën. Identifikon dhe referon jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese të GJEDNJ lidhur me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor. I kushton rëndësi përditësimit të këtyre njohurive, për të njohur dhe aplikuar pjesët e reja të legjislacionit si dhe vendimeve unifikuese. Ajo ka aftësi të dukshme në hartimin e qartë të projektraporteve, në identifikimin e saktë të rrethanave të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Shfrytëzon më së miri, burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi janë të njëjta me ato të cilat ka dhënë edhe Struktura Përgjegjëse Organizative dhe nuk ka komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative të dhënë për këtë tregues. Vlerësimi i dhënë nga Struktura Përgjegjëse Organizative është i plotë dhe i saktë në paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre dhe se vlerësimi i kryer është objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në tërësi, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko-Profesional, të ngritur pranë Komisionit të Përkohshëm Për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të

Gjyqtarëve, ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, të saktë dhe të plotë të të dhënave, identifikimin shumë të qartë natyrës së çështjes, gjetjeve konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit. Gjithashtu, rezultojnë aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e nëpunëses përgjegjëse për përmbledhjen dhe evidentimin e elementëve thelbësorë që lidhen me analizën e gjetjeve, duke përcaktuar qartë dhe në mënyrë të shprehur gjetjet konkrete dhe thelbësore, të cilat analizohen si veçmas, ashtu dhe në tërësi, në funksion të kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim, referuar burimeve të vlerësimit rezultojnë se gjyqtarja identifikoi dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore, të cilat mbështesin argumentimin ligjor të nëpunëses përgjegjëse lidhur me gjetjet në projektraportet e subjekteve të rivlerësimit. Përbën vlerë të shtuar, identifikimi dhe referimi në mbështetje të arsyetimit ligjor, i praktikës së GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, analizohet se: *“Nga burimet e vlerësimit rezultojnë se magjistratja e komanduar {...}, në hartimin e projektraportëve të analizimit të aftësive për 13 subjektet e rivlerësimit (gjyqtarë të shkallës së parë dhe atyre të apelit), ka zbatuar paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre sipas formës standarde të Raportit sipas përcaktimeve të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, e miratuar me Vendimin Nr. 24, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Anekseve, pjesë përbërëse e tij. Nisur nga natyra e akteve të hartuara nga magjistratja e komanduar {...}, evidentohet respektimi dhe*

zbatimi i saktë i parashikimeve të nenit 42 pika 3 të Ligjit Nr. 84/2016, duke u përshkruar saktësisht dhe plotësisht :

- i) Formularit të vetëdeklarimit të paraqitur si dhe 3 dokumentat ligjorë të paraqitur nga vetë subjektet e rivlerësimit si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti,
- ii) 5 dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii) Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Në projektraportet e hartuara, magjistratja identifikon dhe analizon nëse Formulari i Vetëvlerësimit Profesional është plotësuar nga subjekti sipas formës standarde, të parashikuar në shtojcën 4 bashkëlidhur Ligjit Nr. 84/2016 “ Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Analiza ligjore e 3 dokumentave të përzgjedhura e të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të cilat zakonisht përfaqësojnë tre vendime gjyqësore të dhëna prej tij, është realizuar duke ju referuar jo vetëm anës formale të dokumentit, por çfarë është më kryesore, përmbajtjes së tij që përfaqësojnë pjesët e vendimit : pjesës hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivit. Magjistratja në kryerjen e këtij procesi kujdeset të pasqyrojë qartësisht dhe saktësisht ligjin e zbatueshëm në çështjen konkrete, normat e aplikuara nga subjekti, parimet e së drejtës, jurisprudencën e brendshme dhe të jashtme që ka lidhje thelbësore me çështjen e gjykuar. Magjistratja ka vlerësuar interpretimin dhe zbatimin e ligjit material nga gjyqtari në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve apo prapësimeve të palëve si dhe ecurinë e gjykimit në gjykatat më të larta, në rastet kur vendimi i është nënshtruar kontrollit nga këto gjykata. Në evidentimin e gjetjeve lidhur me 5(pesë) dosjet e përzgjedhura me short, nga magjistratja jepet një panoramë e qartë dhe e detajuar e ecurisë së çështjes nga momenti i shortimit të saj tek subjekti i rivlerësimit, ecuria e gjykimit, dhënia e vendimit nga ana e tij, ankimi dhe vendimmarrja e gjykatës më të lartë. Raportet pasqyrojnë hollësisht përmbajtjen e secilës seancë gjyqësore të zhvilluar, analizën e shkaqeve të shtyrjes së gjykimeve nëse janë të justifikuara apo jo në raport me ligjin procedural civil apo penal të aplikueshëm i cili pasqyrohet saktësisht. Magjistratja kujdeset të evidentojë në çdo rast kohëzgjatjen tërësore të procesit, qenia e tyre brenda apo jashtë afateve standarde të gjykimit duke sjellë për zbatim ligjin në rastet kur afatet janë ligjore apo Vendimin e KLD-së nr. 261/2 datë 14.04.2010 “ Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” kur afatet e gjykimit janë afate standarde gjykimi. Në rastet e gjykimeve të evidentuara si jashtë afatit ligjor apo atij standard, magjistratja e komanduar është kujdesur maksimalisht të vlerësojë ata elementë që parashikon jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë mbi kohëzgjatjen e gjykimit, të tilla si : sjelljen e gjyqtarit, sjellja e palëve ndërgjyqëse, kompleksiteti i çështjes apo dhe faktorë të tjerë që mund të kenë ndikuar në tejkalimin e afatit. Në rastet e vendimeve të ankimuara listohen shkaqet e ankimit, arsyet e cenimit nga gjykata më e lartë, duke u kujdesur të evidentojë shkaqet e cenimit nëse ato janë të natyrës procedurale, për zbatim të gabuar të ligjit material apo për vlerësim të gabuar të provave. Element shumë i rëndësishëm i cili në çdo rast ka marrë vëmendjen e duhur nga ana e magjistrates është analiza e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke referuar sipas rastit, në Jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë, njohja e Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, si dhe njohja e Jurisprudencës së GJEDNJ-së etj. Pjesë e analizës së dokumentacionit ligjor nga magjistratja {...} është afati kohor i dorëzimit të vendimit në sekretari, nëse ky afat ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit në

gjykatat më të larta . Gjatë hartimit të projekt-raporteve nga ana e magistrates, normat e ligjit material dhe procedural civil, penal apo administrativ në evidentimin e gjetjeve dhe më pas në analizimin e tyre përkundrejt kritereve të vlerësimit, përveç identifikimit të tyre, janë shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin e drejtpërdrejtë në funksion të analizës së gjetjeve. Në rastet kur çështjet në të cilat janë evidentuar gjetje paraqiten më komplekse, magistratja identifikon referimin e dispozitave procedurale apo materiale jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë nga subjektet e rivlerësimit, ndërsa analizon gjetjet sipas grup kritereve të vlerësimit . Kështu:

- *Në rastin e zgjidhjes së një çështje që i përket ligjit të posaçëm nr. 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” nga një gjyqtar magistratja ka analizuar hollësisht plotësimin e kushteve kumulative të përcaktuara në ligjin e posaçëm për caktim sekuestro (shih raportin për subjektin Dh.H).*
- *Në rastin e analizimit të kohëzgjatjes së gjykimeve administrative, magistratja e komanduar në analizën e gjetjeve ka evidentuar respektimin e standardit të procesit të rregullt ligjor duke referuar nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në të njëjtin raport, në analizën e gjetjeve të dokumentacionit që i përket subjektit të rivlerësimit ka cituar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i cili është i detyrueshëm për zbatim në të njëjtën çështje, duke identifikuar jurisprudencën relevante të caktuar (shih raportin për subjektin e rivlerësimit B.Sh).*
- *Në evidentimin e gjetjeve lidhur me elementët e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe më pas në analizimin e gjetjes shoqëruar me citimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (vendimet nr. 2/2015 dhe 55/2012) lidhur me këtë element (shih raportin për subjektin A.N).*
- *Në të gjitha raportet e hartuara prej saj, vihet re se evidentimi i të gjitha parimeve të teorisë të së drejtës që subjektet kanë përdorur në dokumentat ligjore të paraqitur prej tyre apo të përzgjedhur sipas shortit, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë në zgjidhjen e çështjeve përkundrejt analizimit të gjetjeve në raport me grup kriteret e vlerësimit.*

Nga burimet e vlerësimit konstatohet se magistratja e komanduar shfaq aftësi të dukshme në analizimin e gjetjeve nga burimet që kanë shërbyer për vlerësimin e magistratëve, referuar kritereve të vlerësimit: a) Aftësitë profesionale; b) Aftësitë organizative; c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, të parashikuara shprehimisht në ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Magistratja e komanduar {...}, në projektraportet e hartuara prej saj është kujdesur të analizojë aftësitë e gjyqtarit për të interpretuar dhe zbatuar ligjin procedural në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor sipas detyrimit që buron nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe legjislacioni procedural në fuqi. Magistratja është kujdesur të analizojë gjetjet mbi aftësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit në drejtim të njohuritë ligjore dhe arsytimit ligjor duke evidentuar normat ligjore të zbatuara nga magistratët, parimet e së drejtës, evidentohen karakteristikat të cilat identifikojnë qartazi qasjen e magistratit në një çështje të caktuar, si dhe analiza e

standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, duke referuar sipas rastit, në Jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë, njohja e Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, si dhe njohja e Jurisprudencës së GJEDNJ-së etj. Në analizimin e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, magjistratja e komanduar shfaq aftësi në analizimin e volumit të punës së përbulluar nga subjekti në raport me standardin sasior të punës të parashikuar në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve, si dhe analizohen shkaqet që mund të kenë ndikuar në volumin e punës. Gjithashtu në çdo raport është analizuar aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore dhe për të administruar dosjet. Pjesë e rëndësishme e raporteve të hartuara nga magjistratja ka qenë dhe analizimi i gjetjeve mbi kriterin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, pjesë e të cilat janë etika në punë, integriteti dhe paanshmëria. Në analizimin e gjetjeve për këtë grup kriter janë vlerësuar sjellja e magjistratit në raport me kolegët, stafin administrativ të gjykatës ku ushtron detyrën, me pjesëmarrësit në proces, por edhe jashtë procesit gjyqësor. Një ndër burimet e përdorura nga magjistratja sipas përcaktimeve të ligjit, kanë qenë të dhënat nga burimet arkivore mbi rezultatet e ankesave në adresë të veprimtarisë së gjyqtarit për periudhën 08.10.2013-08.10.2016. Magjistratja ka vlerësuar numrin i kërkesave të subjektit për dorëheqje gjatë gjykimit apo numri i kërkesave për përjashtimin e tij dhe se çfarë është vendosur në rast të kërkesave për përjashtimin e tij nga gjykimi, gjuha e përdorur në arsytimin e vendimit, nëse vërehen fjalë të papërshtatshme apo me karakter denigrues, diskriminues, apo fyes për palët në proces etj. Në analizimin e aftësive personale dhe angazhimit profesional, magjistratja e komanduar shfaq aftësi në analizimin e saktë të gjetjeve nga burimet e vlerësimit, në funksion të vlerësimit të aftësive të komunikimit të gjyqtarit, të aftësive për të bashkëpunuar si dhe vlerësimit të gatishmërisë së magjistratit për tu angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale, apo disponueshmëria për të udhëhequr magjistratët e rinj. Edhe raporti shtesë i hartuar nga magjistratja e komanduar dukshëm reflekton saktësi në identifikimin e ligjit të zbatueshëm në gjetjet e konstatuara. Gjyqtarja ka treguar kujdes në evidentimin e normës kushtetuese Neni Ç i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi detyrimin e organeve në dhënien e informacionit shtesë për organet e vetingut. Kujdeset të japë një informacion të plotë dhe shterues nëse denoncimet e paraqitura për trajtim janë shqyrtuar ose jo më herët në formën e ankesës nga organet kompetente, proces ky i cili realizohej në bashkëpunim të ngushtë me stadin administrativ të KLGJ-së që administrojnë të dhënat arkivore. Magjistratja ka dhënë informacionin përkatës të detajuar, ndërsa për ankesat të cilat paraqiteshin për herë të parë për trajtim, magjistratja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin” dhe ka analizuar plotësimin ose jo të kriterëve të pranueshmërisë së ankesave sipas nenit 120 të këtij ligji. Në analizimin e dokumentit ligjor të paraqitur nga KPK, magjistratja e komanduar ka kryer analizë të plotë mbi aftësitë profesionale të gjyqtarit lidhur me këtë vendimmarrje, ndërsa për të dhënat të cilat mungonin ka orientuar dhënien rrugë, në formën e udhëzimit të kërkesës së KLGJ-së për të marrë akte në Gjykatën respektive”.

Në përfundim Struktura përgjegjëse Organizative, lidhur me këtë tregues konkludon se: “Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko- Profesional të ngritur pranë Komisionit të vlerësimit për efekt vetingu,

shfaq aftësi të larta në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në procesin, për hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Spikat aftësia për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit, arsyeton qartë mënyrën e zbatimit të ligjit në çështjet e trajtuara, dhe siguron lidhjen e drejtpërdrejtë midis gjetjeve të konstatuara dhe dispozitave ligjore të zbatuara. Evidenton në çdo rast, parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale, të cilat kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjeve të trajtuara nga gjyqtari. Në çdo rast analizon zbatimin e jurisprudencën e Gjykatave më të larta, veçanërisht Jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe Jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi janë të njëjta me ato të cilat ka dhënë edhe Struktura Përgjegjëse Organizative dhe nuk ka komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative të dhënë për këtë tregues. Vlerësimi i dhënë nga Struktura Përgjegjëse Organizative është i plotë dhe i saktë në paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre dhe se vlerësimi i kryer është objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në tërësi, gjyqtarja e komanduar {...} gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunëses përgjegjëse ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në mbështetje të analizës së gjetjeve në kuadër të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Po ashtu, rezulton kujdesi i saj për të zbatuar por edhe marrë në analizë parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe për të pasuruar interpretimin e saj mbi ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij, me qëndrime të praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe GJK.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;

- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, analizohet se: *“Nga burimet e vlerësimit rezulton se magjistratja e komanduar {...} në procesin e hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, shfaq aftësi të larta për të shprehur mendimin e saj juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të thjeshta, të kuptueshme, logjike, si dhe zbaton saktësisht rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, konstatohet përdorimi i të gjitha karaktereve të gjuhës shqipe “ ë”, “ç”. Nga ana e saj përdoren fjali me gjatësi mesatare, ndërsa nuk konstatohet përdorimi i fjalive nënrenditëse në fjali çfarë tregon kujdes të shtuar për të qenë sa më e qartë dhe e kuptueshme në aktin e hartuar prej saj, në funksion të perceptimit të tij jo vetëm nga praktikantët e të drejtës. Magjistratja i kushton vëmendjen e duhur strukturës formale, evidentimit të saktë të gjetjeve në dosje, formulimit të qartë dhe të saktë të të gjithë analizës së gjetjeve sipas kriterëve të vlerësimit, duke ndjekur me saktësi formën standarde të miratuar nga Komisioni. Magjistratja kujdeset të evidentojë edhe gjetje të cilat e diferencojnë subjektin e rivlerësimit në një kriter të caktuar sikundërse mund të jetë edhe ana strukturore dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë të hartuar nga subjekti. Konstatohet kujdesi i magjistrates së komanduar për të organizuar gjetjet duke ruajtur rrjedhën logjike të fjalisë në funksion të kuptueshmërisë së saj”.*

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *“...Kam shfaqur aftësi të larta për të shprehur mendimin juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të thjeshta, të kuptueshme, logjike, dhe në zbatim të rregullave gramatikore dhe ato të sintaksës, duke përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe . Jam kujdesur të organizoj gjetjet duke ruajtur rrjedhën logjike të fjalisë në funksion të kuptueshmërisë së saj, si duke përdorur fjali me gjatësi mesatare, duke shmangur fjali nënrenditëse çfarë tregon kujdes të shtuar për të qenë sa më e qartë dhe e kuptueshme në aktin e hartuar nga ana ime në funksion të perceptimit të tij si nga praktikantët e të drejtës, ashtu dhe nga të tretët. I kam kushtuar vëmendjen e duhur strukturës formale, evidentimit të saktë të gjetjeve në dosje, formulimit të qartë dhe të saktë të të gjithë analizës së gjetjeve sipas kriterëve të vlerësimit, duke ndjekur me saktësi formën standarde të miratuar nga Komisioni. I kam kushtuar vëmendje të shtuar evidentimit të gjetjeve të cilat e diferencojnë subjektin e rivlerësimit në një kriter të caktuar sikundërse mund të jetë edhe ana strukturore dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë të hartuar nga subjekti, apo administrimi i procesit gjyqësor. Të njëjtën përkujdesje maksimale si nga ana formale, por dhe substanciale kam treguar edhe në hartimin e akteve në zbatim të detyrave të tjera të kryera me urdhër të Kryetares së KLGJ-së dhe të cituara në Raportin tim përshkues të Punës.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në tërësi, gjyqtarja e komanduar në pozicionin nëpunëses përgjegjëse tregon kujdes të posaçëm për qartësinë dhe koncizitetin e evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të procesit të rivlerësimit, kuptueshmërisë së

analizës së të dhënave të grumbulluara, arsyetimit ligjor dhe paraqitjes së përfundimeve të nxjerra sipas kritereve matëse të vlerësimit, duke ndjekur me saktësi formën standarde të miratuar nga Komisioni.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, analizohet se: *“Nga burimet e vlerësimit rezulton se magjistratja e komanduar {...} në procesin e hartimit të projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, shfaq aftësi të larta në hartimin e akteve me një gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme. Magjistratja i kushton rëndësi strukturës së mirëorganizuar të projektraporteve sipas formës standarde të miratuar, duke i kushtuar rëndësi evidentimit të gjetjeve dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të gjetjeve dhe analizës sipas kritereve të vlerësimit të subjekteve. Të gjitha projekt-raportet e përgatitura prej tij, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen. Në të gjitha projekt-raportet e përgatitura prej saj ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve. Paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit. Përdor me saktësi konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafë sipas rastit. Ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës. Grumbullon në kohë, gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projekt-raporteve profesionale, si dhe dokumenton saktë çdo veprim të kryer prej saj. Edhe raporti shtesë i hartuar nga magjistratja e komanduar dukshëm reflekton saktësi në identifikimin e ligjit të zbatueshëm në gjetjet e konstatuara. Gjyqtarja ka treguar kujdes në evidentimin e normës kushtetuese Neni Ç i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi detyrimin e organeve në dhënien e informacionit shtesë për organet e vetingut, ndërsa kujdeset të analizojë ligjin e zbatueshëm 96/2016 në raport me të dhënat shtesë të kërkuara nga KPK.*

Në të gjitha rastet, projekt-raportet e përgatitura nga ana e magistrates {...}, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje, tregues ky i cilësisë së lartë të hartimit të tyre. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projekt-raport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre, si në aspektin formal ashtu dhe substancial të dokumentit të hartuar nga magistratja”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *“Të gjitha projekt-raportet janë përgatitur nga ana ime sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen, duke ruajtur kronologjinë e çështjeve të trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projektraportit, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafë sipas rastit, duke i paraqitur saktë aktet nga pikëpamja formale, dhe duke i përdorur ato në funksion të organizimit të punës. Kam grumbulluar në kohë gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projekt-raporteve profesionale, si dhe duke dokumentuar saktë këtë dokumentacion edhe me “footnote” në përmbajtje të vetë raportit. Edhe raporti shtesë i hartuar nga ana ime, reflekton të njëjtën qasje në raport me saktësinë e identifikimit të ligjit të zbatueshëm në gjetjet e konstatuara, qartësinë dhe kuptueshmërinë e aktit, gjuhës së përdorur. Të njëjtën përkujdesje maksimale si nga ana formale por dhe substanciale kam treguar edhe në hartimin e akteve në zbatim të detyrave të tjera të kryera me urdhër të Kryetares së KLGJ-së dhe të cituara në Raportin tim përshkues të Punës. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj akteve të hartuara nga ana ime, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre, si në aspektin formal ashtu dhe substancial të dokumentit të hartuar. Aktet janë miratuar nga strukturat përgjegjëse qoftë ajo organizative apo nga Kryetarja e Këshillit, tregues ky i cilësisë së lartë të hartimit të tyre”.*

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja nuk ka pasur komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative, duke vlerësuar se atë objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në tërësi, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e nëpunëses përgjegjëse ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, të projektraporteve sipas formës standarde të miratuar, duke i kushtuar rëndësi evidentimit të gjetjeve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të gjetjeve dhe analizës sipas kriterëve të vlerësimit të subjekteve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, analizohet se: *“Në përmbajtjen e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale dhe etike, konstatohet qartë se magjistratja e komanduar {...} ka aftësi për të analizuar konceptet, institutet dhe dispozitat që lidhen midis tyre. Ajo i kushton vëmendjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Argumentimi ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë patur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, magjistratja zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projekt-raport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre, si në aspektin formal ashtu dhe substancial të dokumentit të hartuar nga magjistratja. Nuk është evidentuar në asnjë rast mangësi në argumentimin ligjor apo mungesë logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur.*

Në përfundim Struktura përgjegjëse Organizative, lidhur me këtë tregues konkludon se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...}, në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko-Profesional të ngritur pranë Komisionit të vlerësimit për efekt vetingu, shfaq aftësi të larta në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar. Spikat aftësia për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit përkundrejt analizës së kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi janë të njëjta me ato të cilat ka dhënë edhe Struktura Përgjegjëse Organizative dhe nuk ka komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative të dhënë për këtë tregues. Vlerësimi i dhënë nga Struktura Përgjegjëse Organizative është i plotë dhe i saktë në paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre dhe se vlerësimi i kryer është objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, evidentohet qartë aftësia e gjyqtares së komanduar në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar, duke treguar dukshëm

aftësi për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarit përkundrejt analizës së kriterëve të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtarës së komanduar, aftësia e saj për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”. Në pikëzimin e këtij treguesi, konsiderohen edhe të dhënat lidhur me mungesën e rasteve kur dokumentet ligjore të hartuara prej saj të jenë kthyer nga struktura përgjegjëse organizative për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në dokumentet ligjore burim vlerësimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Referuar “Raportit përshkrues vjetor të punës”**, rezulton se gjyqtarja e komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunëses përgjegjëse pranë Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etiko dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve ka hartuar 14 (katërbëdhjetë) projektraporte standarde të analizimit të aftësive profesionale për 13 (trembëdhjetë) gjyqtarë nga të cilët 10 (dhjetë) projektraporte u përkasin gjyqtarëve pranë gjykatave të apelit dhe 3 (tre) projektraporte u përkasin gjyqtarë të gjykatave të shkallës së parë. Ndërkohë ka hartuar edhe 1 (një) projektraport shtesë i cili ka pasur për objekt pune vlerësimin e denoncimeve të shtetasve ndaj një gjyqtari tjetër. Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, në zbatim edhe të Rregullores së miratuar nga KLGJ, ka marrë pjesë në të gjitha shortet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në bashkëpunim me Komisionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e 5 (pesë) dosjeve me short në funksion të hartimit të projektraporteve për subjektet e rivlerësimit. Në periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020 përtej detyrave të kryera si nëpunëse përgjegjëse/inspektore në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, me urdhër të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor gjyqtarja është ngarkuar me detyra të tjera me natyrë: pjesëmarrje në 3 (tre) grupe pune, përfaqësime në 2 (dy) procese gjyqësore, si dhe grumbullim informacioni mbi problematika të pretenduara nga subjekte të ndryshme ndaj veprimtarisë së disa kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve si dhe kancelarëve, apo zbatim vendimesh të KLGJ-së, në 6 (gjashtë) raste.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se : *“Referuar burimeve të vlerësimit, si dhe të dhënave të Raportit përshkrues të punës, rezulton se magjistratja e komanduar {...}, në periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020, ka përballuar një volum të lartë pune. Në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse pranë Njësisë Mbështetëse të Komisionit të Përkohshëm, ka përfunduar dhe dorëzuar pranë Komisionit, 13(trembëdhjetë) projektraporte të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë të shkallëve të para si dhe për gjyqtarë apeli. Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, në zbatim edhe të Rregullores së miratuar nga KLGJ, magjistratja ka marrë pjesë në të gjitha shortet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në bashkëpunim me Komisionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e 5 dosjeve me short në funksion të hartimit të projektraporteve për subjektet e rivlerësimit. Shortet e organizuara kanë qenë për një numër më të lartë subjektesh nga ato për të cilat janë hartuar raportet në këtë periudhë nga ana e magjistrates, në varësi kjo të kërkesave dhe prioriteteve të KPK-së. Vlen të theksohet se në procesin e paraprak të administrimit të të dhënave statistikore, si dhe në procesin e përzgjedhjes së dosjeve, magjistratja e komanduar {...}, ka shfaqur përkushtim maksimal në drejtim të bashkëpunimit me stafin e gjykatave dhe stafin administrativ të KLGJ për të administruar të dhëna të sakta statistikore në funksion të objektivitetit dhe saktësisë së përzgjedhjes së 5 dosjeve me short sipas natyrës së çështjeve të gjykuara. Magjistratja në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse dhe person i ngarkuar me përgjegjësinë e saktësisë së përzgjedhjes së dosjeve nën mbikëqyrjen e anëtarit të KLGJ-së, ka shfaqur impenjim maksimal në funksion të saktësisë dhe shpejtësisë së përzgjedhjes së akteve, ndërsa ka spikatur dhe kreativiteti i saj në zgjidhjen e situatave të paraqitura. Pas hedhjes së shortit, magjistratja, si pjesë rutine e procesit të hartimit të raportit në bashkëpunim me*

stafin ndihmës të këtij procesi, ka treguar kujdes në administrimin e dosjeve respektive nga gjykata respektive ku ato ndodheshin. Në vijim janë hartuar projektaktet e analizimit të aftësive të gjyqararit, ku kohëzgjatja e këtij procesi varion në varësi të kompleksitetit të çështjeve objekt trajtimi. Rregullorja e miratuar nga KLGJ nuk disiplinon afate për shkak të kompleksitetit të çështjes, por dhe për faktin se procesi ka natyrë që ndjek ritmin dhe përparësitë e kërkuara Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për llogari të të cilit kryer ky proces. Në përputhje me udhëzimet e KPK-së të përcjella nëpërmjet anëtarit të Komisionit të KLGJ-së në cilësinë e relatorit, magjistratja ka u ka dhënë prioritet përgatitjes së akteve sipas udhëzimit për ato subjekte të kërkuara me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Magjistratja e komanduar {...} ka shfaqur përkushtim maksimal për përfundimin e projektraporteve në kohë sa më shpejtë të mundshme, pa cënuar në asnjë rast cilësinë e përmbajtjes së tyre. Bazuar në Raportin përshkruar statistikor të hartuar nga magjistratja e komanduar {...}, rezulton se tej detyrave funksionale të hartimit të projektraporteve profesionale, ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar asaj nga struktura eprore administrative dhe përkatësisht Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me natyrë: pjesëmarrje në grupe pune, përfaqësime gjyqësore si dhe grumbullim informacioni mbi problematika të pretenduara nga subjekte të ndryshme ndaj veprimtarisë së disa kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve si dhe kancelarëve, apo zbatim vendimesh të KLGJ-së.

Kështu: Gjatë periudhës objekt vlerësimi, rezulton se Znj. {...}, ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 2 (dy) procese gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Apelit. Në ato procese gjyqësore, ka përgatitur prapësimet por edhe konkluzionet me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara gjykatës. Rezultoi gjithashtu, se gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, magjistratja {...} ka marrë pjesë në 3 Grupe Pune të ngritura me urdhër të posaçëm nga Kryetarja e KLGJ-së:

-Urdhri Nr. 135, datë 10.04.2019 “Për hartimin e projekt-raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018”, ku sipas përshkimit të vetë magistrates në Raportin përshkruar detyra e saj ka qenë raportimi i të dhënave mbi veprimtarinë e Nënpunësve Përgjegjës të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, përsa i takon procesit të hartimit të raporteve profesionale për subjektet e rivlerësimit kalimtar (gjyqtarëve). Magjistratja ka referuar se kontributi i saj ka qenë në nivel statistikor për numrin e subjekteve që u është përfunduar raporti i analizimit të aftësive, gjykatat ku ata kanë ushtruar detyrën, si dhe problematikat e hasura gjatë procesit në tërësi, ndërsa pjesë e detyrës sime në këtë grup pune kanë qenë diskutimet mbi performancën e gjykatave sipas numrit të gjyqtarëve, çështjet e përfunduara në raport me ato të caktuara.

-Urdhri Nr. 198 datë 31.07.2019 “Për evidentimin dhe regjistrimin e praktikave të paprotokolluara në Zyrën e Protokoll arkivës nga inspektorët”.

-Urdhri Nr. 210 datë 12.09.2019 “Shtesë urdhri nr.198 datë 31.07.2019, për evidentimin edhe të praktikave të inspektorit Piro Samara, i cili ka paraqitur dorëheqjen”, ku sipas përshkrimit të vetë magistrates, kontributi i saj ka qenë përpilimi i tabelave standarde për hedhjen uniformë të të dhënave sipas natyrave të praktikave në proces pune pranë inspektorëve, në funksion të qartësisë dhe plotësisë së pasqyrimin të tyre. Magjistratja ka raportuar kontributin e saj në orientimin e grupit të punës për zgjidhjen e situatave të cilat për nga natyra e tyre kërkonin njohuri të posaçme profesionale dhe teknike, të hasura sidomos në evidentimin e praktikave të inspektorit P.Samara një pjesë e të cilave ishin shumë të hershme.

Referuar Raportit përshkues së punës të paraqitur nga magjistratja e komanduar, rezulton se në periudhën e vlerësimit ajo ka qenë e ngarkuar nga detyra të tjera të përgjithshme të natyrës verifikim pretendimesh apo zbatim vendimesh të KLGJ-së, duke grumbulluar informacion, akte, marrje shpjegime dhe raportim Kryetares së KLGJ-së mbi rezultatet përkatëse.

Kështu sipas të dhënave të deklaruara prej saj, rezulton se me urdhër të Kryetares së KLGJ-së ka marrë pjesë në 6 verifikime të rasteve të iniciuara nga ankues apo magjistratë për çështje të cilat krijojnë problematika të vlerësuara nga Kryetarja për trajtim. Në përfundim të secilës detyrë të ngarkuar, pas vizitave në terren, grumbullimit të dokumentacionit dhe marrjes së shpjegimeve përkatëse nga subjektet e parashikuara në secilin urdhër, magjistratja ka deklaruar se në bashkëpunim me secilin prej kolegëve pjesë e grupit të punës, është hartuar Relacioni respektiv mbi të gjitha të dhënat e evidentuara, si dhe me një analizë ligjore të gjetjeve të konstatuara. Në zbatim të urdhrave të caktuar, secili prej raporteve i është dorëzuar Kryetares së KLGJ-së menjëherë pas përpilimit të tij”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkues vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, gjyqtarja vlerësohet maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtares së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit dhe situatës faktike të lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre është shprehur aftësi e lartë në respektim të volumit dhe afateve për realizmit e punës, si dhe në aspektin procedural dhe saktësisë”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se *për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020, ka përbulluar një volum të lartë pune, referuar si detyrës funksionale, ashtu dhe numrit dhe llojit të detyrave të tjera në të cilat ka qenë e angazhuar. Kështu, në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse pranë Njësisë Mbështetëse të Komisionit të Përkohshëm, gjyqtarja parashtron se ka përfunduar dhe dorëzuar pranë Komisionit 13 (trembëdhjetë) projektraporte të analizimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë të shkallëve të para si dhe për gjyqtarë apeli. Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, në zbatim edhe të Rregullores së miratuar nga KLGJ, ka marrë pjesë në të gjitha shortet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në bashkëpunim me Komisionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor për përzgjedhjen e 5 dosjeve me short në funksion të hartimit të projektraporteve për subjektet e rivlerësimit. Pas hedhjes së shortit, në bashkëpunim me stafin ndihmës të këtij procesi, ka treguar kujdes në gjurmimin e dosjeve në varësi të gjykatës ku ato ndodheshin, si dhe ka hartuar projektaktet e analizimit të aftësive të gjyqtarit, ku kohëzgjatja e këtij procesi varion në varësi të kompleksitetit të çështjeve objekt trajtimi me një mesatare prej 3 javë. Tej detyrave funksionale të hartimit të projektraporteve profesionale, gjyqtarja parashtron se ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar nga struktura eprore administrative, me natyrë të tillë si: pjesëmarrje në 3 (tre) grupe pune, përfaqësime në 2 (dy) procese gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe 6 (gjashtë) verifikime të rasteve të iniciuara nga ankues apo magjistratë ndaj veprimtarisë së disa kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve si dhe kancelarëve, apo zbatim vendimesh të KLGJ-së.*

Në konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi gjyqtarja nuk ka komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative të dhënë për këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} është vlerësuar maksimalisht nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, si për përballimin e volumit të punës së caktuar nga Komisioni pranë të cilit ka punuar ashtu edhe për shkak të angazhimit në detyra të tjera. Për pasojë, në lidhje me treguesin “Aftësia për të realizuar volumin normale të punës” aftësia e saj rezulton shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Aftësia për të realizuar volumin normale të punës”, aftësia e gjyqtarës së komanduar vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Magjistratja e komanduar {...}, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur detyrat që i janë caktuar. Në hartimin e projektraporteve të analizimit të aftësive profesionale, magjistratja ka respektuar në çdo rast afatet e vendosura nga strukturat eprore, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera, jo vetëm në afat por edhe në cilësi. Nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të magjistrates së komanduar”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarës së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit dhe situatës faktike të lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre gjyqtarja e komanduar ka*

realizuar në kohë reale dhe afate të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore detyrat e ngarkuara për trajtim, mbështetur në të dhëna të konstatuara”.

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi janë të njëjta me ato të cilat ka dhënë edhe Struktura Përgjegjëse Organizative dhe Administrative, pavarësisht faktit se nga ana e strukturës përgjegjëse administrative nuk paraqiten shpjegime detajuese lidhur me kriteret e vlerësimit, por nga ana e kësaj strukture është mbajtur në konsideratë volumi i punës dhe natyra e detyrave të kryera, të cilat tregojnë angazhimet e gjyqtarës në procese të ndryshme e të shumta pune pranë Këshillit, të cilat në çdo rast nuk kanë cënuar afatet e proceseve të secilës punë.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} është vlerësuar maksimalisht nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, pasi në çdo rast ajo ka respektuar afatet e vendosura nga strukturat eprore, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera, jo vetëm në afat, por edhe në cilësi. Nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të magjistrates së komanduar. Për pasojë, në lidhje me treguesin “Aftësia për të respektuar afatet” aftësia e saj rezulton shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Aftësia për të respektuar afatet”, aftësia e gjyqtarës së komanduar vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

2.B. Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së

gjqtares së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...}, në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko-Profesional të ngritur pranë Komisionit të vlerësimit për efekt vetingu, shfaq aftësi në qenien efektiv në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprore. Me marrjen e detyrës së caktuar, shfaq qartësi në identifikimin e shpejtë të veprimeve të nevojshme për tu kryer, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre, duke qenë efektive në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera në funksion të arritjes së një objekti në planet e punës të realizuar nga ana e saj. Magjistratja shfaq aftësi në dallimin e çështjeve, trajtimi i të cilave ka përparësi dhe merr masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Magjistratja në çdo rast është kujdesur në bashkëpunimin maksimal me anëtarët e Komisionit pranë të cilit ka qenë e komanduar, me anëtarët e tjerë të Këshillit, me strukturat administrative të Këshillit në funksion të përmbushjes në afat të detyrave të ngarkuara. Si pjesëmarrëse në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga Urdhri përkatës i nxjerrë nga struktura eprore”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtares së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur shkallë shumë e lartë aftësie për veprime procedurale, në shfrytëzim të kohës, burimeve në dispozicion, si dhe aftësia organizative”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësoj se kam aftësi në qenien efektive në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprore. Me marrjen e detyrës së caktuar, kam shfaqur qartësi në identifikimin e shpejtë të veprimeve të nevojshme për tu kryer, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre, duke qenë efektive në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera në funksion të arritjes së një objekti në planet e punës të realizuar nga ana ime. Kam shfaqur aftësi në dallimin e çështjeve, trajtimi i të cilave ka përparësi dhe merr masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Kam shfaqur bashkëpunim maksimal me anëtarët e Komisionit pranë të cilit kam qenë e komanduar, me anëtarët e tjerë të Këshillit, me strukturat administrative të Këshillit në funksion të përmbushjes në afat të detyrave të ngarkuara. Si pjesëmarrëse në grupe pune, kam shfaqur gatishmëri maksimale me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga Urdhri përkatës i nxjerrë nga struktura eprore. Lidhur me hartimin e projektraporteve të vetingut, siç dhe kam shpjeguar më lart, u kam dhënë përparësi hartimit për subjektet të cilat janë kërkuar me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, praktikë pune kjo e ndjekur nga Komisioni, duke mos u bërë pengesë për asnjë prej hallkave të tjera të procesit. Në varësi të natyrës së detyrës së lënë nga Kryetarja e KLGJ-së, u kam dhënë prioritet detyrave të cilat kishin pritshmëri në paraqitjen informacioneve të shpejta e të sakta për zgjidhjen e problematikave të caktuara në Gjykata, sikundërse ka qenë rasti i urdhrin nr.156 datë 06.05.2019 “Për grumbullimin e informacionit mbi veprimtarinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi zbatimin e Vendimit të KLGJ-së, nr. 47 datë 18.03.2019”.*

Nuk rezulton që gjyqtarja të ketë pasur komente apo kundërshtime lidhur me vlerësimin e strukturës përgjegjëse organizative, duke e vlerësuar se vlerësimi është objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues. Ndërsa në lidhje me vlerësimin e strukturës përgjegjëse administrative, gjyqtarja vlerëson se pavarësisht faktit se nuk paraqet shpjegime detajuese lidhur me kriteret e vlerësimit, nga ana e kësaj strukture është mbajtur në konsideratë gatishmëria e saj e lartë në ofrimin e bashkëpunimit me të gjithë strukturat, me qëllim realizimin e tyre sipas përparësive të kërkuara nga struktura përkatëse apo nga natyra e detyrës së ngarkuar.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të punës për kryerjen e vlerësimeve profesionale apo në kryerjen e detyrave të tjera të caktuara, rezulton angazhimi maksimal i gjyqtarës së komanduar për ndjekjen e një metodologjie efektive në drejtim të organizimit të punës. Për pasojë, aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe pikëzohen maksimalisht.

Shkalla e aftësisë dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Magjistratja e komanduar {...}, si në rastin e hartimit të projektraporteve profesionale, qoftë standarde apo raporti shtesë, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Në çdo rast ajo shfaq kujdes të*

shtuar për të renditur aktet sipas kronologjisë së hartimit të dokumentit me qëllim qenien e tij lehtësisht i shfrytëzueshëm. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtares së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur aftësi shumë të lartë rregullsie dhe saktësie në përpilim të dokumentacioneve, të cilat kanë qenë të shfrytëzueshme nga struktura kompetente”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi janë të njëjta me ato të cilat ka dhënë edhe Struktura Përgjegjëse Organizative dhe Administrative, pavarësisht faktit se nga ana e strukturës përgjegjëse administrative nuk paraqiten shpjegime detajuese lidhur me kriteret e vlerësimit, por nga ana e kësaj strukture është mbajtur në konsideratë kujdesi i treguar nga ana e gjyqtares në rregullshmërinë dhe renditjen e akteve, në funksion të lehtësisë së shfrytëzimit të dokumentacionit.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} tregon kujdesin e duhur që aktet e dosjes të jenë të administruara dhe renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin kronologjik të hartimit të dokumentit dhe në tërësi e bëjnë materialin lehtësisht të shfrytëzueshëm nga çdo përdorues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkruar vjetor të punës së gjyqtares së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...}, në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse në Njësinë e Vlerësimit Etiko-Profesional të ngritur pranë Komisionit të vlerësimit për efekt vetingu, ka shfaqur aftësi në përballimin e një volumi të lartë pune duke përmbushur në kohë dhe me cilësi të gjitha detyrat që i janë ngarkuar, si nga Komisioni i Përkohshëm Për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Procesit të Rivlerësimit Kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, ashtu edhe detyrat e ngarkuara nga strukturat e tjera eprore administrative të KLGJ-së. Në secilën prej detyrave të cilat i janë ngarkuar për t’i kryer Znj. {...} ka menaxhuar mjaft mirë kohën për përmbushjen e tyre me cilësi profesionale, por edhe brenda një afati të arsyeshëm, duke qenë efektive dhe produktive njëkohësisht. Magjistratja e komanduar shfaq aftësi për të menaxhuar në mënyre efektive kohën dhe burimet në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës. Shfaq aftësi të dukshme për të evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi, ndërsa nuk ka munguar dhe kreativiteti për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës, sidomos në procesin e përzgjedhjes së çështjeve me short për efekt analize në raportin e vetingut. Magjistratja është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Në çdo rast ajo shfaq kujdes të shtuar për të renditur aktet sipas kronologjisë së hartimit të dokumentit me qëllim qenien e tij lehtësisht i shfrytëzueshëm”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtares së komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dokumentacioni i hartuar dhe përgatitur ka qenë konkret, referuar për sa është kërkuar për trajtim”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“...Jam kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar, duke mos pasur asnjëherë mangësi apo ngatërrim dokumentacioni. Në çdo rast kam shfaqur kujdes të shtuar për të renditur aktet sipas kronologjisë së hartimit të dokumentit me qëllim, qenien e tij lehtësisht i shfrytëzueshëm”.* Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} tregon kujdesin e duhur që aktet e dosjeve të jenë të rregullta, të plota dhe të sakta në aspektin formal të tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA ORGANIZATIVE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. Etika në punë

3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Lidhur me këtë aspekt, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative, konkludohet se: “Magjistratja e komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu është konstatuar komunikim etik me të gjithë aktorët e përfshirë edhe në procesin e shortimit të dosjeve për efekt analize në raportet e rivlerësimit të magjistratëve. Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi por edhe përtej saj, pra deri më sot, nuk rezulton që në adresë të saj të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga subjektet e rivlerësimit apo nga çdo person tjetër. Respektimi i normave të etikës nga ana e saj është vlerësuar dhe kuptuar, jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj. Nga të dhënat e raportit përshkues dhe ato të disponuara nga Këshilli nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje e cila të dëshmojë për cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës së komanduar”.

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar gjatë periudhës së vlerësimit ka shprehur dhe zbatuar në shkallë të lartë parimet e etikes, komunikimit, transparencës”*.
- Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Lidhur me këtë tregues kam shfaqur maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Të njëjtën përkujdesje maksimale në komunikim kam treguar edhe me të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë edhe në procesin e shortimit të dosjeve për efekt analize në raportet e rivlerësimit të magjistratëve. Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi por edhe përtej saj, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga subjektet e rivlerësimit apo nga çdo person tjetër. Respektimi i normave të etikës është edukatë e mësuar në familje dhe që reflektohet padiskutim në çdo aspekt”. Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative”. Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.*
- Referuar informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.1435/1 prot., datë 09.05.2023, protokolluar në Këshill me nr.2641/3 prot., datë 11.05.2023, rezulton se për gjyqtaren e komanduar znj.{...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk është dhënë ose zbatuar masë disiplinore. Po kështu, edhe për sa i përket ankesave, referuar të njëjtit informacioni të dërguar nga ILD rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020, ndaj gjyqtares {...} nuk është depozituar asnjë ankesë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtares së komanduar, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri maksimale në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja e komanduar ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin *“Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”* vlerësohet *“Shumë e lartë”* duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B. Integriteti i gjyqtarit të komanduar

3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer, magjistratja {...} ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e magjistratit. Në ushtrimin e detyrës së saj magjistratja ka demonstruar cilësi personale të mençurisë, ndjenjës së humanizmit, shfaqjes së guximit në dhënien e zgjidhjeve praktike situatave të papritura, duke patur gjithmonë në konsideratë se sjellja e saj profesionale dhe jo vetëm ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimit që publiku ka për organet e drejtësisë, përfshi Këshillin ku magjistratja ka qenë e komanduar. Në asnjë rast nuk është konstatuar që magjistratja të ketë shfaqur njëanësi në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të ketë favorizuar, disfavorizuar, apo paragjykuar ndonjë prej tyre. Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e saj gjatë ushtrimit të detyrës. Profesionalizmi, ndershmëria, përgjegjshmëria, respekti dhe vlerësimi për të tjerët, humanizmi, janë tipare thelbësore të karakterit të magjistrates {...}”*.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar gjatë periudhës së vlerësimit ka shfaqur dinjitet të lartë duke ndjekur dhe zbatuar parimin e bashkëpunimit, me dinjitet, përgjegjshmëri dhe me vlera të larta personale dhe profesionale”*.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Në ushtrimin e detyrës jam përpjekur të demonstroj cilësi personale të mençurisë, ndjenjës së humanizmit, shfaqjes së guximit në dhënien e zgjidhjeve praktike situatave të papritura, duke patur gjithmonë në konsideratë se sjellja ime profesionale ndikon edhe në imazhin e drejtësisë dhe besimit që publiku ka për organet e drejtësisë, përfshi vetë Këshillin ku kam qenë e komanduar. Në asnjë rast nuk kam shfaqur njëanësi në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të kem favorizuar, disfavorizuar, apo paragjykuar ndonjë prej tyre, ku qoftë dhe perceptimi i këtyre sjelljeve, është përtej logjikës së një profesionisti. Sjellja ime në çdo rast ka qenë tejet korrekte, duke vepruar me përgjegjshmëri, e profesionalizëm në realizimin me ndershmëri por dhe me guxim të detyrave të ngarkuara”*. Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative”. Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

➤ Referuar informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr.1435/1 prot., datë 09.05.2023, protokolluar në Këshill me nr.2641/3 prot., datë 11.05.2023, rezulton se për periudhën 01.01.2019-07.02.2020, ndaj gjyqtares {...}, nuk rezulton të jetë paraqitur ankesë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Po kështu, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren {...} nuk është dhënë asnjë e tillë.

➤ Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 230/23 prot., datë 30.03.2021, konkludohet se *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar

3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, magjistratja e komanduar {...} shfaq kujdes në qenien e paanshme dhe në perceptimin nga të tretët të kësaj paanësie, detyrim që duhet përmbushur në mënyrë të padiskutueshme. Në asnjë rast në aktet e hartuara nga ana e saj nuk rezulton të ketë dhënë konsiderata personale, ndërsa evidentohet të ketë mbajtur qëndrime tërësisht profesionale. Në*

aktet e përgatitura nga ana e saj tregon kujdes të shtuar në zgjedhjen e fjalëve dhe fjalive, duke shmangur çdo lloj fjale apo fjalie të papërshtatshme, me natyrë diskriminuese apo paragjyquese. Nga të dhënat e burimeve në asnjë rast nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa për njëanshmëri në përmbushjen e detyrës. Nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë, që të vënë në dyshim paanësinë e saj në ushtrimin e detyrës”.

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është mbështetur në parimet bazë të komunikimit, duke mos qenë diskriminues”*.

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, kam treguar kujdes të shtuar në qenien e paanshme dhe në perceptimin nga të tretët të kësaj paanësie, detyrim që duhet përmbushur në mënyrë të padiskutueshme. Në asnjë rast në aktet e hartuara nga ana ime nuk kam dhënë konsiderata personale, duke mbajtur qëndrim tërësisht profesional. Kam treguar përkujdesje maksimale në zgjedhjen e fjalëve dhe fjalive, duke shmangur çdo lloj fjale apo fjalie të papërshtatshme, me natyrë diskriminuese apo paragjyquese. Jo vetëm në periudhën objekt vlerësimi, por në të gjithë periudhën time të komandimit, në asnjë rast nuk kam pasur raste të konfliktit të interesit, dhe në dijeninë time nuk është paraqitur ndonjë ankesë për njëanshmëri në përmbushjen e detyrës. Kam shfaqur kujdes dhe në asnjë rast nuk përdor gjuhë diskriminuese apo elementë të tjerë, që të vënë në dyshim paanësinë time të padiskutueshme në ushtrimin e detyrës”*. Nuk rezulton të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se znj. Pepi ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuarra për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga të dhënat e raportit përshkues dhe ato të disponuara nga Këshilli nuk rezultojnë asnjë e dhënë apo indicje e cila të dëshmojë për cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës së komanduar. Magjistratja {...} ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e magjistratit. Në ushtrimin e detyrës së saj magjistratja ka demonstruar cilësi personale të mençurisë, ndjenjës së humanizmit, shfaqjes së guximit në dhënien e zgjidhjeve praktike situatave të papritura, duke patur gjithmonë në konsideratë se sjellja e saj profesionale dhe jo vetëm ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimit që publiku ka për organet e drejtësisë, përfshi Këshillin ku magjistratja ka qenë e komanduar. Në asnjë rast nuk rezultojnë të ketë paraqitur dorëheqje apo të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga trajtimi i çështjeve të caktuara”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit, nuk ka refuzuar heqjen dorë nga trajtimi i procedurave administrative, në përputhje edhe me parimin e paanshmërisë”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Lidhur me këtë kriter vlerësimi vlerësoj se në asnjë rast, nuk kam kërkuar të heq dorë nga kryerja apo përmbushja e ndonjë detyre që më është ngarkuar nga eprorët apo nga strukturat përgjegjëse organizative apo administrative. Në dijeninë time, nuk rezultojnë të jetë paraqitur ndonjë kërkesë për përjashtimin tim nga procesi i shortimit dhe i përgatitjes së projektraportëve të analizimit të aftësive etiko –profesionale dhe për rrjedhojë s ka asnjë vendimarrje të kësaj natyre”.* Nuk rezultojnë të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, numri i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarës të komanduar nga një procedurë administrative, për nëpunësen përgjegjëse {...} vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se nga të dhënat burim vlerësimi rezultojnë se nuk ka asnjë kërkesë të paraqitur për përjashtimin e saj, si dhe nuk ka asnjë kërkesë për heqje dorë nga përgatitja e dokumenteve ligjore për çështjet e caktuara, e për rrjedhojë, asnjë kërkesë të refuzuar të mëparshme, për të njëjtin shkak.

Numri i kërkesave të pranuar për përjashtim/heqje dorë të refuzuara dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative” gjyqtarja e komanduar pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A. Aftësia e komunikimit

4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, rezulton se magjistratja e komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Komunikimi i saj karakterizohet nga përdorimi i e të thjeshta, të qarta dhe konçize, transparente dhe efektive në informacionin që kërkon të përcjellë. Magjistratja shfaq atësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të. Në çdo rast, komunikimi i saj ka qenë në respektim të plotë të normave etike të*

detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur komunikim shumë të lartë. Ka qenë i qartë, kuptueshëm dhe transparent”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se në çdo rast, komunikimi ka qenë në respektim të plotë të normave të komunikimit formal gjatë ushtrimit të detyrës. Nuk rezulton që gjyqtarja e komanduar të ketë parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, për këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të nëpunëses përgjegjëse në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët. Përkundrazi evidentohen aftësitë e saj për komunikimin korrekt dhe të drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e komunikimit formal gjatë ushtrimit të detyrës.

***Qartësia dhe transparenca e komunikimit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar {...} gjatë ushtrimit të detyrës, ka treguar kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin subjekte të rivlerësimit, por edhe kategorive të tjera të zyrtarëve shtetërorë me të cilët ka*

ndërvepruar në përmbushje të detyrave të tjera që i janë ngarkuar atij nga strukturat drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka respektuar parimin e konfidencialitetit duke ruajtur në mënyrë koncize çdo të dhënë konfidenciale”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Megjithë mungesën e të dhënave specifike për këtë tregues, vlerësoj se në dokumentat e hartuara nga ana ime si ato të lidhura me detyrën ku jam komanduar ashtu dhe ato të kryera mbi bazë urdhri të Kryetares, nuk kam cenuar konfidencialitetin apo të dhënat personale të subjekteve dhe pjesëmarrësve në proces. Kjo vihet re edhe në përdorimin e referencave me iniciale në këtë vetëvlerësim pune. Jam përpjekur të tregoj kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale për të cilat kam ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Lidhur me këtë tregues, vlen të theksohet se vëmendja ime ka qenë e shtuar edhe duke marrë pjesë në trajnim vazhdues të organizuar nga SH.Magjistraturës me temë “Mbrojtja e të dhënave personale sipas legjislacionit shqiptar... Ligji për të drejtën e informimit dhe analiza krahasimore e të drejtës për informim me mbrojtjen e të dhënave personale, cila prej këtyre prevalon?”, trajnim i zhvilluar përgjatë periudhës së vlerësimit, në datë 25 Nëntor të vitit 2019”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja {...} ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit apo vlerësimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin *“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”* vlerësohet *“E lartë”* duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;

- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar {...} gjatë ushtrimit të detyrës, ka shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë të komanduar në KLGJ, duke shkëmbyer me ta njohuri dhe përvojën e saj profesionale. Komunikimi i saj me kolegët ka qenë gjithmonë i hapur dhe i sinqertë. Një komunikim dhe bashkëpunim korrekt, magjistratja rezultoi të ketë patur edhe me stafin administrativ të KLGJ-së, si në rastin e përfaqësimit të KLGJ-së në procese gjyqësore, ashtu edhe në bashkëpunimet që ka patur në Grupet e Punës të ngritura me urdhër të Titullarit të KLGJ-së. Natyra e grupeve të punës në të cilat magjistratja {...} ka marrë pjesë dhe që i ka raportuar në Raportin Përshkues të Punës ka qenë të tilla që kanë kërkuar kontribut në çështje të ndryshme mbi performancën e sistemit gjyqësor në vitin 2018, propozime për përmirësimin e tyre, propozimet e ndryshme në varësi të të dhënave të grumbulluara mbi problematikat për verifikimin e të cilave është ngarkuar nga ana e Kryetares së KLGJ-së. Magjistratja ka shfaqur disponibilitet në përfshirjen e saj në grupet e ndryshme të punës sikundërse i liston në Raportin Përshkues dhe bashkëpunim për të ndarë me kolegët praktikant më të mira të punës”.*
- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur bashkëpunim dhe etikë, duke shkëmbyer përvojë profesionale”.*
- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“... jo vetëm përgjatë periudhës së vlerësimit, kam shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë të komanduar në KLGJ, duke shkëmbyer me ta njohuri dhe përvojën time profesionale, duke ndërtuar një komunikim të hapur dhe të sinqertë. Bashkëpunimi im me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Etiko-Profesional është karakterizuar nga një komunikim tejet korrekt, duke treguar kujdes në funksion të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për zbatimin e detyrave. Komunikimi korrekt dhe profesional është vendosur nga ana ime edhe në marrëdhëniet e krijuara për shkak detyre me stafin administrativ të KLGJ-së, si në rastin e përfaqësimit të KLGJ-së në procese gjyqësore, ashtu edhe në bashkëpunimet që kam patur në Grupet e Punës të ngritura me urdhër të Titullarit të KLGJ-së. Kontributi im në grupet e punës të ngritura për evidentimin e praktikave pranë ish-inspektorëve të KLD-së, ka qenë në zbatim të këtij komunikimi, duke ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me të gjithë pjesëmarrësit në proces. Pjesëmarrja ime në grupet e ndryshme të punës të ngarkuara nga Kryetarja e Këshillit është karakterizuar nga disponibiliteti për të qenë sa më bashkëpunuese, duke ndarë me kolegët edhe praktikant më të mira të punës në funksion të harmonizimit të këtyre praktikave”.*

Nga analiza e të dhënave burimore të vlerësimit të pasqyruara më sipër, evidentohet aftësia e lartë e gjyqtarës së komanduar në drejtim të komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, pasi rezultoi e qartë se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qenë në nivel të lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot, datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka qenë bashkëpunues, i gatshëm dhe efektiv edhe në detyra të ngarkuara edhe në pjesëmarrje në grupe pune duke dhënë kontributin maksimal”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Sikundërse kam përshkruar edhe në Raportin e Punës të paraqitur për efekt të këtij vlerësimi, rezultoi se kam qenë e gatshme dhe kam dhënë kontribut me pjesëmarrjen time aktive në 3 grupe pune të ngritura me urdhër të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor:*

1. *Urdhri Nr. 135 datë 10.04.2019 “Për hartimin e projektraportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin 2018”.*

Sipas këtij urdhri dhe në zbatim të detyrës së caktuar midis anëtarëve të grupit të punës, nga ana ime janë relatuar të dhëna mbi veprimtarinë e Nëpunësve Përgjegjës të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, përsa i takon procesit të hartimit të raporteve profesionale për subjektet e rivlerësimit kalimtar (gjyqtarëve). Të dhënat kanë qenë të natyrës statistikore për numrin e subjekteve që u është përfunduar raporti i analizimit të aftësive, gjykatat ku ata kanë ushtruar detyrën si dhe problematikat e hasura gjatë procesit në tërësi. Gjithashtu pjesë e detyrës sime në këtë grup pune kanë qenë diskutimet mbi performancën e gjykatave sipas numrit të gjyqtarëve, çështjet e përfunduara në raport me ato të caktuara.

2. Urdhri Nr. 198 datë 31.07.2019 “ Për evidentimin dhe regjistrimin e praktikave të paprotokolluara në Zyrën e Protokoll arkivës nga inspektorët”;
3. Nr. 210 datë 12.09.2019 “Shtesë urdhri nr.198 datë 31.07.2019, për evidentimin edhe të praktikave të inspektorit Piro Samara, i cili ka paraqitur dorëheqjen”.

Lidhur me këto 2 grupe punë, në zbatim të detyrave të përcaktuara midis anëtarëve të grupit të punës, nga ana ime janë përpiluar tabela standarde për hedhjen uniforme të të dhënave sipas natyrave të praktikave në proces pune pranë inspektorëve, në funksion të qartësisë dhe plotësisë së pasqyrimit të tyre. Këto tabela u janë shpërndarë inspektorëve për tu plotësuar me qëllim unifikimin e informacionit dhe përpunimin më të lehtë të tij. Si pikë kontakti, kam mbajtur korrespondencë me inspektorët dhe pas plotësimit të të dhënave, ato i janë përcjellë drejtuesit të grupit të punës. Gjithashtu kam dhënë kontribut në orientimin e grupit të punës për zgjidhjen e situatave të cilat për nga natyra e tyre kërkonin njohuri të posaçme profesionale dhe teknike, të hasura sidomos në evidentimin e praktikave të inspektorit P.Samara një pjesë e të cilave ishin shumë të hershme....Pjesëmarrja ime në këto grupe pune ka ndikuar në rritjen e aftësive të mia në kryerjen edhe të detyrave të tjera me natyrë të ndryshme nga ato gjyqësore, çfarë e bën vlerë të shtuar timen lidhur me këtë tregues. Përgjatë periudhës së vlerësimit, sikundërse e kam pasqyruar edhe në Raportin e punës të depozituar për efekt të këtij vlerësimi, kam qenë e ngarkuar nga Kryetarja e Këshillit me detyra të tjera të përgjithshme të natyrës verifikim pretendimesh apo zbatim vendimesh të KLGJ-së, duke grumbulluar informacion, akte, marrje shpjegime dhe raportim Kryetares mbi rezultatet përkatëse. Kështu, me urdhër të Kryetares së KLGJ-së kam marrë pjesë në 6 verifikime të rasteve të iniciuara nga ankues apo magjistratë për çështje të cilat krijojnë problematika të vlerësuara nga Kryetarja për trajtim, si vijon:

1. Urdhri nr. 156 datë 06.05.2019 “Për grumbullimin e informacionit mbi veprimtarinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi zbatimin e Vendimit të KLGJ-së, nr. 47 datë 18.03.2019”.

Në zbatim të detyrës së caktuar nga Kryetarja e Këshillit, rreth veprimtarisë së kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi zbatimin e Vendimit të KLGJ-së, nr. 47 datë 18.03.2019, u paraqitën gjetjet dhe konstatimet të cilat në vijim sollën dhe zhbllokimin e situatës së krijuar lidhur me ecurinë e një procesi gjyqësor në këtë gjykatë.

2. Urdhri nr. 236 datë 20.11.2019 Për grumbullimin e informacionit lidhur me problematikat paraqitura në shkresën e gjyqtarit Ken Dhima të Gj.Admin.Shk.Parë Vlorë, ndaj Kryetarit, Kancelarit dhe Kryesekretarit të gjykatës”.

Në zbatim të detyrës mbi problematikat e ngritura nga gjyqtari K.Dh, ndaj veprimtarisë së Kryetarit të Gj.Admin.Shk.Parë Vlorë, Kancelarit dhe Kryesekretarit të gjykatës u evidentuan të dhënat e grumbulluara lidhur me secilën veprimtari duke u paraqitur dhe sugjerimet përkatëse sipas gjetjeve për secilin subjekt.

3. Urdhri nr. 357 datë 17.12.2019 Për grumbullimin e informacionit mbi problematikat e paraqitura në ankesën e shtetasit Skerdilajd Qinami, ndaj Kancelarit dhe Kryesekretares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Në zbatim të detyrës, mbi grumbullimin e informacionit mbi problematikat e paraqitura në ankesën e shtetasit Skerdilajd Qinami, ndaj Kancelarit dhe Kryesekretares së

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, problematika e ngritur nga ankuesi mbi ankimin e subjektit dhe aktet e tij u paraqit para Kryetares së bashku me gjetjet respektive në analizë të përgjegjesisë së mundshme disiplinore të administratës në këtë proces.

4. Urdhri nr. 358 datë 17.12.2019 Për grumbullimin e informacionit lidhur me problematikat paraqitura në shkresën e gjyqtarit Ken Dhima të Gj.Admin.Shk.Parë Vlorë, ndaj Kryetarit, Kancelarit dhe Kryesekretarit të gjykatës”.

Në zbatim të detyrës mbi problematikat e ngritura nga gjyqtari K.Dh, ndaj veprimtarisë së Kryetarit të Gj.Admin.Shk.Parë Vlorë, Kancelarit dhe Kryesekretarit të gjykatës u evidentuan të dhënat e grumbulluara lidhur me secilën veprimtari duke u paraqitur dhe sugjerimet përkatëse sipas gjetjeve për secilin subjekt.

5. Urdhri nr. 2 datë 08.01.2020 Për grumbullim informacioni “Mbi rastin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë ndaj gjyqtares Enkeleida Hoxha të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.

6. Urdhri nr.3 datë 13.01.2020 Për grumbullim informacioni “Mbi rastin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Në dy detyrat e ngarkuara në vitin 2020 lidhur me informacionin e grumbulluar mbi rastet e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë ndaj gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë dhe Elbasan, pas një analize të vendimmarrjeve respektive dhe analizës së dispozitave penale të shkeluara nga gjyqtarët, Grupi i punës ka sugjeruar përcjelljen e materialit organit kompetent ILD menjëherë me ngritjen e tij, duke treguar dhe kujdes në realizimin e bashkëveprimit ndërinstitucional sipas fushës së veprimit të secilit organ. Detyrat e përcaktuara në urdhër janë realizuar në bashkëpunim me secilin prej kolegëve pjesë e grupit të punës, pas vizitave në terren, grumbullimit të dokumentacionit dhe marrjes së shpjegimeve përkatëse nga subjektet e parashikuara në secilin urdhër. Ndërkohë Relacioni mbi të gjitha të dhënat e evidentuara, si dhe me një analizë ligjore të gjetjeve të konstatuara janë hartuar nga ana ime në bashkëpunim me anëtarin tjetër të grupit, duke sugjeruar propozime mbi zgjidhjen e situatave të konstatuara sipas legjislacionit të zbatueshëm. Në zbatim të urdhrave të caktuar, secili prej raporteve i është dorëzuar Kryetares së KLGJ-së menjëherë pas përpilimit të tij. Përveç detyrave të sipërcituara, nga ana ime është dhënë kontribut maksimal sa herë është kërkuar në takime pune të Komisioneve të ndryshme të Këshillit për çështje të cilat kanë pasur të bëjnë me hartimin e rregulloreve të ndryshme nga ana e këtyre komisioneve. Ky kontribut është dhënë verbalisht në mbledhjet e zhvilluara ashtu dhe në komunikim elektronik për çështje të cilat kanë qenë për diskutim. Evidentimi i këtyre të dhënave tregon përkushtimin tim maksimal dhe angazhim efektiv edhe në realizimin e detyrave të tjera tej atyre të caktuara nga Komisioni i Vlerësimit Etiko –Profesional të cilat kanë ndikuar jo vetëm në përmirësimin e punës në Këshill, por edhe në aftësimin tim personal në kryerjen e detyrave të tjera, përveç atyre me karakter të pastër gjyqësor”. Në mbështetje të së cilës gjyqtarja e komanduar ka depozituar edhe kopje komunikimeve të postes elektronike (e-mail) të cilat dokumentojnë kontributin e saj të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në Metodologjinë e Pikëzimit përcaktohet se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri dy pikë të tjera, iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, aftësia e saj në lidhje me këtë tregues pikëzohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

***Gatishmëria dhe kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit” vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë*

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023, për periudhën 01.01.2019-07.02.2020;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Lidhur me këtë kriter vlerësohet se magjistratja e komanduar {...}, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Shfaq atësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të. Në çdo rast, komunikimi i saj, ka qenë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile. Magjistratja ka treguar kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin subjekte të rivlerësimit. Magjistratja e komanduar {...} gjatë ushtrimit të detyrës, ka shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë të komanduar në KLGJ, duke shkëmbyer me ta njohuri dhe përvojën e saj profesionale. Komunikimi i saj me*

kolegët ka qenë gjithmonë i hapur dhe i sinqertë. Pjesëmarrja e saj në Grupet e Punës që i ka raportuar në Raportin Përshkues të Punës tregon kontribut në çështje të ndryshme mbi performancën e sistemit gjyqësor në vitin 2018, propozime për përmirësimin e tyre, propozimet e ndryshme në varësi të të dhënave të grumbulluara mbi problematikat për verifikimin e të cilave është ngarkuar nga ana e Kryetares së KLGJ-së. Ka shfaqur bashkëpunim dhe gatishmëri për zgjidhjen e situatave të caktuara, duke nxitur marrëdhëniet bashkëpunuese në Këshill në funksion të krijimit të një ambienti pune jo vetëm harmonik por dhe produktiv”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka qenë shumë bashkëpunues me strukturat funksionale, duke ofruar zgjidhje të mundshme me shfaqje të etikës profesionale”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Lidhur me këtë kriter vetëvlerësoj se kam manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me anëtarët e Këshillit, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Jam përpjekur të shfaq aftësi të larta komunikuese, duke respektuar mendimin dhe qëndrimin edhe të bashkëbiseduesit. Në çdo rast, komunikimi im ka qenë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile, duke treguar kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin pjesëmarrësve në proces për të cilat kam ardhur në dijeni për shkak funksioni. Kam shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë të komanduar në KLGJ, duke shkëmbyer me ta njohuri dhe përvojë profesionale, bashkëpunim i cili është karakterizuar nga një komunikim i hapur dhe i sinqertë. Pjesëmarrja ime në Grupet e Punës dhe në detyrat e tjera të ngarkuara, të cilat i kam detajuar si në Raportin Përshkues të Punës ashtu dhe më lart në treguesin e performancës të numërtuar 4.B-b, vlerësoj se tregon përkushtimin tim maksimal dhe angazhim efektiv edhe në realizimin e detyrave të tjera tej atyre të caktuara nga Komisioni i Vlerësimit Etiko–Profesional të cilat kanë ndikuar jo vetëm në përmirësimin e punës në Këshill, por edhe në aftësimin tim personal në kryerjen e detyrave të tjera, përveç atyre me karakter të pastër gjyqësor. Kam shfaqur bashkëpunim dhe gatishmëri për zgjidhjen e situatave të caktuara, duke nxitur marrëdhëniet bashkëpunuese në Këshill në funksion të krijimit të një ambienti pune jo vetëm harmonik por dhe produktiv”.*

Nga analiza e të dhënave burimore të vlerësimit të pasqyruara më sipër, nuk rezultojnë të dhëna për ekzistencën e situatave të konfliktit apo mënyrës së menaxhimit të tyre, raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës dhe reagimi i saj për zgjidhjen e tyre me efikasitet dhe duke ruajtur qetësinë dhe etikën, ndërkohë që struktura përgjegjëse organizative dhe administrative e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja shfaq aftësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të. Në çdo rast, komunikimi i saj, ka qenë në respektim

të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civilë.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevoje për gjyqtaren e komanduar {...} është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: *“Përgjatë periudhës së vlerësimit kam marrë pjesë në 10 aktivitete trajnuese të formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, në total 16 ditë...”*
- **Nga të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës**, me shkresën nr.301/17 prot., datë 05.05.2023, rezulton se gjyqtarja {...} ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses në 12 (dymbëdhjetë) aktivitete, të zhvilluara gjithsej në 20 ditë kalendarike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020 ka marrë pjesë në programin e Trajnimit Vazhdues në 12 (dymbëdhjetë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses të zhvilluar në 20 ditë kalendarike. Ndërkohë nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë marrë pjesë në aktivitete të formimit profesional, jashtë programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 12 aktivitete trajnuese, brenda programit të Formimit

Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve ligjorë (5 deri në 40 ditë në vit), sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit nr.96/2015, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj, pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës civile dhe penale

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës së komanduar në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarës të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: *“Përgjatë periudhës së vlerësimit, megjithë disponueshmërinë time, nuk kam angazhim konkret si ekspert apo lehtësues në trajnim fillestar apo vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, apo nga institucione të tjera. Kjo situatë ka ardhur edhe për shkak të natyrës prioritare që kishte procesi i hartimit të raporteve të analizimit të aftësive etiko-profesionale të gjyqtarëve për llogari të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Ky proces merrte prioritet në raport me çdo angazhim tjetër në funksion si të bashkëpunimit ndërinstitucional ashtu dhe të përmbushjes së detyrimit ligjor për hartimin e tyre me qëllim shmangien e pengesave të mundshme të këtij procesi tejet jetik për drejtësinë, për këtë shkak”.*

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri në dy pikë të tjera iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren e komanduar {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja e komanduar vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar” gjyqtarja ka deklaruar se: “Kam marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Forumit Shqiptar të Grave Gjyqtare, projekt i USAID, organizuar në datë 11 Janar 2019, si dhe në disa takime të tjera të organizuara nga ky Forum....Nga ana tjetër kam dhënë kontribut maksimal sa herë është kërkuar në takime pune të Komisioneve të ndryshme të Këshillit për çështje të cilat kanë pasur të bëjnë me hartimin e rregulloreve të ndryshme nga ana e këtyre komisioneve. Ky kontribut është dhënë verbalisht në mbledhjet e zhvilluara ashtu dhe në komunikim elektronik për çështje të cilat kanë qenë për diskutim”. Në mbështetje të vetëvlerësimit gjyqtarja ka paraqitur komunikimet elektronike lidhur me këtë pjesëmarrje, si dhe komunikimet elektronike me kryetaren e Komisionit përkatës.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, gjyqtari gjatë periudhës që është i komanduar në Këshill, mund të angazhohet dhe të bëjë përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme, në angazhime të tjera që nuk lidhen me pozicionin e tij të punës në Këshill apo me detyra të ngarkuara nga strukturat drejtuese të Këshillit. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike. Pjesëmarrja në këto veprimtari duhet të respektojë jo vetëm kuadrin ligjor, por edhe rregullat përkatëse të etikës të miratuara nga Këshilli për këtë qëllim.

Referuar formularit të vetëvlerësimit të gjyqtares së komanduar së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se znj. Pepi, në periudhën e vlerësimit 01.01.2019-07.02.2020, ka marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Forumit Shqiptar të Grave

Gjyqtare, të zhvilluar në datën 11.01.2019. Në komunikimin elektronik të paraqitur nga gjyqtarja vërtetohet pjesëmarrja në këtë aktivitet, por jo shkalla e pjesëmarrjes dhe kontributi i saj në këtë veprimtari.

Duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe nga një ose dy pikë të tjera do t'iu shtohen në vlerësim në rast se këto veprimtari kryhen jashtë veprimtarisë së tyre si të komanduar në Këshill, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultoi angazhimi i saj në veprimtari të kësaj natyre.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, për treguesin “Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultoi angazhimi i saj në aktivitete të kësaj natyre.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Vetëvlerësimi i gjyqtares të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në “Vetëvlerësimin e gjyqtares të komanduar” gjyqtarja ka deklaruar se: “Nuk kam angazhime të kësaj natyre në periudhën e vlerësimit”.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me zero (0) pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë të dhëna dhe për këtë ky tregues të pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit
KRITERI

AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësia profesionale	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësia organizative	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I
VLERËSIMIT
I GJYQTARES TË KOMANDUAR ZNJ. {...}
PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-.07.02.2020**

1. AFTËSIA PROFESIONALE			
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë

	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
--	---	---	---------------

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE

Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës	a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023; 4. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të respektuar afatet	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë	Shumë e lartë

		17.05.2023; 4.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	
B. Efektiviteti dhe metodologjia	a. Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023; 4.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë
C. Rregullshmëria dhe saktësia	a. Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit	1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023; 2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023; 4.Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.	Shumë e lartë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit	<p>1. Raport përshkrues vjetor i gjyqtares të komanduar me nr.2778 prot., datë 08.05.2023;</p> <p>2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023;</p> <p>3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023;</p> <p>4. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023.</p>	Shumë e lartë
--	--	--	---------------

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<p>1. Informacioni i marrë nga ILD (<i>rezultatet e verifikimit të ankesave</i>)</p> <p>2. Dosja personale e gjyqtares (<i>masat disiplinore...etj</i>)</p> <p>3. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;</p> <p>4. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023;</p> <p>5. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.</p>	Shumë e lartë

<p>B. Integriteti i gjyqtares</p>	<p>a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti</p>	<p>1. Informacioni i marrë nga ILD (<i>rezultatet e verifikimit të ankesave</i>)</p> <p>2. Dosja personale e gjyqtares (<i>masat disiplinore...etj</i>)</p> <p>3. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;</p> <p>4. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023;</p> <p>5. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023;</p> <p>6. Raporti i ILDKPKI.</p>	<p>Shumë e lartë</p>
<p>C. Paanësia e gjyqtares</p>	<p>a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese</p>	<p>1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;</p> <p>2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023;</p> <p>3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.</p>	<p>Shumë e lartë</p>
	<p>b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtares të komanduar nga një procedurë administrative</p>	<p>1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;</p> <p>2. Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023;</p> <p>3. Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.</p>	<p>I pa konsiderueshëm</p>

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023; 2.Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023; 2.Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023; 2.Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.	Shumë e lartë
	b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë	Ka të dhëna

	nga strukturat drejtuese të Këshillit	16.06.2023; 2.Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.	
	c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023; 2.Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative, me nr.2778/2 prot., datë 22.05.2023; 3.Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, me nr.2778/1 prot., datë 17.05.2023.	Shumë e lartë
C. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të tjera të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtares të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023; 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Çdo e dhënë tjetër që provon angazhimin dhe kontributin konkret	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares, me nr.2778/3 prot., datë 16.06.2023;	Nuk ka të dhëna

		3. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			3
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMITTË GJYQTARES			SHKËLQ

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR